




TË VEPROSH PËR TË MIRËN E VENDIT

DEMOKRACIA NË VEPRIM

BLENDION (14), ABDULLAH (15), BESFORT (15), ILIRJANA (15), FESLINDA (14), JETA (15), MEMET (14)

ERANDA (15)



Të dashur lexues nga ne do të mësoni se cili është ndikimi ynë në shtetin tonë

Demokracia është qeverisje e popullit. Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje apo pushtet. Elementet që e përbëjnë demokracinë janë: liria, paqja, respekti, solidariteti, toleranca, barazia etj. Dy llojet më të njohura të demokracisë janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: në sistemin parlamentar dhe në sistemin presidencial. Demokracia e drejtpërdrejtë zbatohet tek shtetet që kanë numërtë vogël të banorëve dhe vendimet merren aty për aty. Kurse demokracia përfaqësuese zbatohet tek shtetet që kanë numër më të madh të banorëve, ku populli i zgjedh përfaqësuesit e vet të cilët janë deputetët. Shteti ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare dhe ne jemi shumë të lumtur për

këtë fakt, që nga moshën 18 vjeçare kemi të drejtë t'i zgjedhim përfaqësuesit tanë (deputetët).

Të jetosh në demokraci do të thotë të shprehësh mendimin tënd lirshëm, të kontribuosh për të ardhmen e shtetit tënd dhe t'i respektosh të tjerët. Asnjëherë s'duhetharruar setë gjithë qytetarët kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin e demokracisë. Së bashku mund të bëjmë ndryshime të mëdha për shtetin tonë. Për shembull, ne edhe pse nuk e kemi të drejtën e votimit deri në moshën 18 vjeçare, mund t'i zbatojmë elementet e tjerat e demokracisë. Kjo nënkupton se ne mund t'i ndihmojmë të tjerët, të jemi tolerant dhe të respektueshëm ndaj të tjerëve dhe të solidarizohemi me ta. Qytetarë të dashur mesazhi ynë për ju është: na ndihmoni ta ndërtojmë edhe më shumë demokracinë, sepse të gjithë duam të jetojmë në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Ndryshimi fillon ngati, andaj bëhu ti pjesë e ndryshimit.



Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik



Gazetarët e demokracisë

ZGJEDHJET ÇELËSI I NJË SHTETI

SHKËLQIM (14), ANJESA (14), KADISHE (15), TAURESA (14), EURON (14), ILIR (14), PREMTIM (15),
ALTIN (14)

Një shtet pa demokraci është si një pranverë pa lule, kështu që ne dëshirojmë që pranvera jonë të ketë gjithmonë lule


Zgjedhjet janë procesi më i rëndësishëm i një shteti. Meanë te zgjedhjeve qytetarët vendosin se kush do t'i udhëheqata për 4 vjetët në vijim. Fushatat realizohen zakonisht para zgjedhjeve. Partitë politike realizojnë fushatat e tyre, ku në këto fushata ato shfaqin programet e tyre. Zgjedhjet ndahen në zgjedhje lokale dhe zgjedhje qendrore. Në zgjedhjet lokale populli zgjedh ansambleistët dhe kryetarin e komunës. Kurse në zgjedhjet qendrore, zgjedhen kandidatët për deputetë. Sipas ligjit në Kosovë, ne nuk mund të votojmë në zgjedhje lokale dhe qendrore deri në moshën 18 vjeçare. Kjo nuk do të thotë se ne nuk mund të votojmë dhe të bëjmë zgjedhje të ndryshme në jetën tonë të përditshme.




Autorët e artikullit




Jo racizmit



Kutia e votimit për President të Kosovës



Mendimi i lirë



Çekani i drejtësisë

KUVENDI ËSHTË SHTËPIA JONË

MIMONDA (14), ALTIN (14), DJELLZA (15), ARNIS (14), ANTIGONA (14), VALON (14), ALBINA (15),
XHENETA (14)



NE JEMI SHTET DEMOKRATIK MULTIETNIK PRANDAJ TË GJITHË
JEMI TË BARABARTË PARA LIGJIT.

Ne jemi ata të cilët vendosim se kë do ta zgjedhim si përfaqësuesin tonë

Kuvendi ose ndryshe Parlamenti, është shumë i rëndësishëm si në jetën politike ashtu edhe në jetën shoqërore, sepse aty miratohen ligjet. Kuvendi ka tri funksione kryesore: funksioni legjislativ, funksion përfaqësues dhe funksioni kontrollues.

Funksioni legjislativ shërben për propozimin, miratimin dhe shfuqizimi e ligjeve. Këtë punë e kryejnë deputetët.



Ne jemi e tashmja dhe e ardhmja e vendit tonë

Kosovak gjithsej 120 deputetë. Në Kuvend, deputetët na përfaqësojnë ne qytetarët dhe marrin vendime për ne. Kosova është vend multi-etnik dhe komunitetet jo shumicë të cilat jetojnë në Kosovë janë: komuniteti turk, romë, ashkali, serb, egjiptian dhe boshnjak. Këto komunitete zënë gjithsej 20 vende në Kuvendin e Kosovës, ndërsa 100 vende të tjera, u përkasin depu-

tetëve shqiptarë.

Qytetarët të cilët dëshirojnë që një ligj të ndërrohet, e paraqesin atë projektligj në Kuvend dhe me votat e hapura të deputetëve shfuqizohet një ligj tjetër dhe vendoset një ligj i ri.

Kuvendin funksion përfaqësues sepse deputetët janë përfaqësuesit tanë në Kuvend.

Ndërsa funksioni i fundit është funksioni kontrollues. Quket kështu sepse Kuvendin e Kosovës ka përdetyrë të kontrollojë Qeverinë. Kjo sepse Qeveria ka përdetyrë t'i ekzekutojë ligjet të cilat miratohen në Kuvend.

Mesazhi ynë për të gjithë ju lexues të dashur është që të besojmë në vetvetesë sepse dëshirojmë të ndërrojmë më të afërt ne do t'i përfaqësojmë qytetarët e Kosovës. Prandaj, sa më të përkushtuar e më të përgjegjshëm të jemi, aq më shpejt do të zhvillohet vendi ynë.



Kuvendi i Republikës së Kosovës



Lirshëm shprehim mendimin tonë



Drejtësia në demokraci



Deputetja duke folur para qytetarëve




Udhëheqja e popullit



Njëra nga format e votimit



Votimi, zgjedhja e përfaqësuesve tanë



Kosova, vend demokratik



Ne jemi qytetarë të përgjegjshëm



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Abetarja“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX/2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Softaj, Ferizaj